




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE



Datë : 25.07.2018

Në bazë të Ligjit mbi Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068 ,  
UA Nr.10 / 2018 dhe në bazë të nenit 8, paragrafi 1,2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, lidhur me  
kushtet dhe kriteret për themelimin e marrëdhënies së punës , Drejtori i Drejtorisë për Arsim  
në Fushë Kosovë shpallë:

### K O N K U R S për këto vende të lira

**1. Shkolla Filllore e Mesme e Ulët “ Selman Riza “ – Fushë Kosovë**

- Një arsimtar të gjuhës angleze me kohë të caktuar deri sa të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë

**2. Shkolla Filllore e Mesme e Ulët “ Mihal Grameno “ – Fushë Kosovë**

- Gjashtë arsimtarë klasor

**3. Shkolla e Mesme e Lartë “Hivzi Sulejmani “ Fushë Kosovë**

- Një arsimtar të biologjisë për kohë të caktuar , deri sa të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë
- Një arsimtar të gjeografisë për kohë të caktuar , deri sa të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë
- Një arsimtar të edukatës fizike

**4. Shkolla Filllore dhe e Mesme e Ulët “ Zejnel Salihu “ – Bardh i Madh  
PNF- Pomozotin**

- Një arsimtar klasor me kohë të caktuar , deri sa të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë

**Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Mësim klasor në Shkollë të Mesme të Ulët:**

- ☐ Fakulteti i Edukimit – programi fillor
- ☐ Fakulteti i Mësuesisë

**Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Gjuhë angleze në Shkollë të Mesme të Ulët:**

- ☐ Fakulteti i Edukimit – programi: Gjuhë dhe letërsi angleze
- ☐ Fakulteti Filologjik – Gjuhë dhe letërsi angleze

**Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Gjeografi në Shkollë të Mesme të Lartë:**

- ☐ Fakulteti i Edukimit – Programi Master në Gjeografi ose Gjeografi - Edukatë Qytetare;
- ☐ Sistemi katërvjeçar;
- ☐ Bachelori (katërvjeçar)

**Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Biologji në Shkollë të Mesme të Lartë:**

- ☐ Fakulteti i Edukimit – Programi Master në Biologji
- ☐ Sistemi katërvjeçar;
- ☐ Bachelori (katërvjeçar)

**Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Edukatë fizike në Shkollë të Mesme të Lartë:**

- ☐ Fakulteti i Edukimit – Programi Master në Ed. Fizike
- ☐ Sistemi katërvjeçar;
- ☐ Bachelori (katërvjeçar)

**Dokumentacioni i nevojshëm :**

- Të jetë banor i Kosovës - letërnjoftimi
- CV
- Çertifikata e lindjes
- Diploma e fakultetit
- Vertetimi se nuk është nën hetime

**Sqarim :** Në Shkollën Filllore dhe të Mesme të Ulët ( 1 – 5 ), kandidatët duhet të kenë së paku 240 ECTS, përkatësisht 4 vjet , kurse në ciklin (6 – 9 ) dhe (10 – 12 ) duhet të kenë 300 ECTS . Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim. Testi me shkrim në maksimum tërheqë 100 pikë apo deri në 50% të vlerësimit përfundimtar.

Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohet intervistimit me gojë. Në intervistën me gojë, kandidatët mund të vlerësohen në maksimum deri 100 pikë apo 50% e vlerësimit përfundimtar.

Vlerësimi në intervistimin me gojë, bazohet në këto kriterë:

- Njohuritë e Përgjithshme 25 pikë,

- Aftësitë e përgjithshme dhe Personalitetit 35 pikë dhe
- Njohuritë profesionale 40 pikë (ku përfshihen përvoja e punës dhe nota mesatare gjatë studimeve).

Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjidhen në pozitat e lartcekura.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diploma të nostrifikuara nga MASHT-I .

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test dhe intervistë, si dhe orari i intervistave publikohet në web faqen e Komunës së FushëKosovës <https://kk.rks-gov.net/fushekosova/> (konkurset) dhe përmes e-mailit (sipas të dhënave në aplikacionin e kandidatit)

Me këtë konkurs zhvillohen procedurat e rekrutimit për vitin shkollor shtator, 2018 – gusht, 2019 (komplet viti shkollor). Në rast të ndonjë nevojë eventuale për mësimdhënës/e në institucione shkollore, do të bëhen angazhime sipas renditjes së listave të publikuara me rastin e shpalljes së rezultateve.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Afati i konkursit është 15 ditë prej datës së shpalljes .

Dokumentacioni komplet dorëzohet në Zyrën pritëse në katin përdhësë , në ndërtesën e Komunës së Fushë Kosovës .

Adresa : rruga e Pejës , p.n . - Fushë Kosovë

